



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykesues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 korrik 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Lluka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veseli

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Trupi Gjykues”), në bazë të nenit 41(6), (10), dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Historiku procedural në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të Jakup Krasniqit (“z. Krasniqi”) është shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme.¹ Zhvillimet relevante që nga rishikimi i pesëmbëdhjetë i paraburgimit të z. Krasniqi më 15 maj 2024 (“Vendimi i Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin”)² përfshijnë si në vijim.
2. Më 24 qershor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS-ja”) dorëzoi parashtrimet mbi rishikimin e pesëmbëdhjetë të paraburgimit të z. Krasniqi (“Parashtrimet e ZPS-së”).³
3. Më 4 korrik 2024, Mbrojtja e z. Krasniqi (“Mbrojtja e Krasniqit”) u përgjigj ndaj parashtrimeve të ZPS-së (“Përgjigjja”).⁴
4. ZPS-ja u kundërpërgjigj ndaj Përgjigjes më 12 korrik 2024 (“Kundërpërgjigjja”).⁵

¹ *Shih p.sh.* F01110, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Gjashtë për Paraburgimin”), 18 nëntor 2022, konfidencial, para. 1-15 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F01110/RED).

² F02313, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 15 maj 2024.

³ F02401, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 24 qershor 2024.

⁴ F02426, Mbrojtësja e Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimit të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 4 korrik 2024, konfidencial dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më të njëjtën ditë, F02426/CONF/RED).

⁵ F02440, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj F02426*, 12 korrik 2024.

II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja kërkon vazhdimin e paraburgimit të z. Krasniqi.⁶ Ajo argumenton se, në mungesë të ndryshimit të rrethanave që nga Vendimi i Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin, mbajtja në paraburgim e z. Krasniqi vazhdon të jetë e domosdoshme dhe e arsyeshme.⁷ ZPS-ja parashtron gjithashtu se ecuria e mëtejshme e gjykimit dhe zhvillime të tjera në çështjen gjyqësore shtojnë domosdoshmërinë e paraburgimit të z. Krasniqi.⁸

6. Mbrojtja e z. Krasniqi kërkon që Trupi Gjykes të autorizojë lirimin e përkohshëm të z. Krasniqi dhe t'i lejojë z. Krasniqi që, gjatë pushimit veror të gjykatës, të kalojë tre javë në vendin të cilin Mbrojtja e Krasniqit e përcaktoi në Përgjigje ("vendi i përcaktuar").⁹ Ajo argumenton se përcaktimi i disa masave gjatë një periudhe relativisht të shkurtër të lirit të përkohshëm do të ulte deri në një shkallë të tolerueshme rrezikun e pengimit të procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera.¹⁰

7. ZPS-ja kundërpërgjigjet se Përgjigjja përmban redaktime të shumta që parandalojnë në mënyrë të parregullt parashtrimin e një përgjigje të njëmendtë dhe se Trupi Gjykes nuk duhet të marrë parasysh pjesën e redaktuar.¹¹ ZPS-ja parashtron gjithashtu se, në ato pjesë të Përgjigjes që pati në dispozicion ZPS-ja, Mbrojtja nuk ka paraqitur asnjë argument që do të zvogëlonte domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e vazhdimin të paraburgimit.¹²

⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 29.

⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6, 28.

⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

⁹ Përgjigjja, para. 2, 9, 16-17.

¹⁰ Përgjigjja, para. 9.

¹¹ Kundërpërgjigjja, para. 3.

¹² Kundërpërgjigjja, para. 4.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Dispozitat ligjore të zbatueshme për vendimin në lidhje me paraburgimin përcaktohen në nenin 41(6), (10), dhe (12) dhe rregullat 56 dhe 57, dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme.¹³ Trupi Gjykues do t'i zbatojë këto standarde në këtë vendim.

IV. RISHIKIMI I RREGULLT I PARABURGIMIT

9. Qëllimi i rishikimit të paraburgimit çdo dy muaj në pritje të gjykimit sipas nenit 41(10) është që të përcaktohet nëse ende ekzistojnë arsye që përligjin paraburgimin.¹⁴ Ndryshimi i rrethanave, ndonëse nuk është përcaktues, do të merret parasysh nëse shtrohet para trupit gjykues përkatës, ose *proprio motu*.¹⁵

A. KRITERET E NENIT 41

i. Dyshimi i bazuar

10. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara ("DHS"). Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.¹⁶

11. ZPS-ja argumenton se, në mungesë të ndonjë ndryshimi të rrethanave që nga vendimi për konfirmimin e aktakuzës dhe Vendimi i Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin, vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Krasniqi ka kryer vepra

¹³ *Shih p.sh.* Vendimin e Gjashtë për Paraburgimin, para. 18-21.

¹⁴ IA022/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 22 gusht 2022, konfidencial, para. 37 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA022/F00005/RED).

¹⁵ IA010/F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 19 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA010/F00008/RED).

¹⁶ *Shih* ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222.

penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së.¹⁷ Mbrojtja e Krasniqit nuk parashtron asgjë konkrete në lidhje me këtë pikë.

12. Trupi Gjykses kujton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi se, në pajtim me nenin 39(2), ekzistonte dyshimi i bazuar mirë se z. Krasniqi është penalisht përgjegjës për një numër krimesh kundër njerëzimit (përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) dhe krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a).¹⁸ Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se është vërtetuar gjithashtu se ekziston dyshimi i bazuar mirë sa u përket akuzave të reja që ZPS-ja ka paraqitur kundër z. Krasniqi.¹⁹ Këto konstatime u bënë duke u bazuar në standardin më të lartë se ai i

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 7 (me referenca të mëtejshme).

¹⁸ F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 521(a)(i)-(ii). Versioni i redaktuar konfidencial (F00026/CONF/RED), versioni i redaktuar publik (F00026/RED), dhe versioni konfidencial me më pak redaktime (F00026/CONF/RED2) u protokolluan, përkatësisht, më 19 nëntor 2020, 30 nëntor 2020, dhe 21 shtator 2023. ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar si F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020; F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar*, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial. Aktakuza e konfirmuar e korrigjuar më tej u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, ZPS-ja dorëzoi versionin konfidencial, të korrigjuar dhe me më pak redaktime të aktakuzës së konfirmuar, F00647/A01.

¹⁹ F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 183. Versioni i redaktuar konfidencial (F00777/CONF/RED), versioni i redaktuar publik (F00777/RED), versioni konfidencial me më pak redaktime (F00777/CONF/RED2), dhe versioni konfidencial edhe me më pak redaktime (F00777/CONF/RED3) u protokolluan, përkatësisht, më 22 prill 2022, 6 maj 2022, 16 maj 2022, dhe 21 shtator 2023. Ndryshimet e kërkuara janë dhënë në hollësi në para. 11. Aktakuza e konfirmuar e ndryshuar u protokollua pastaj nga ZPS-ja më 29 prill 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05). Më 30 shtator 2022, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar me ndryshime të mëtejshme ("Aktakuza e Konfirmuar"), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00999/A01; riklasifikuar si konfidenciale dhe statusi *ex parte* u hoq më 26 janar 2023), me versionin e redaktuar konfidencial (F00999/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00999/A03; versioni publik me më pak redaktime [F01296/A03] dhe versionin publik edhe me më pak redaktime [F01323/A01] u protokolluan, përkatësisht, më 15 shkurt 2023 dhe 27 shkurt 2023), siç urdhëroi Gjykatësi i Procedurës Paraprake (F00895, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës së*

dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a).²⁰

13. Në mungesë të ndonjë rrethane të re thelbësore që do të ndikonte në konstatimet e mësipërme, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Krasniqi ka kryer krime që përfshihen në juridiksionin lëndor të DHS-së, sipas nenit 41(6)(a) dhe (10).

ii. Domosdoshmëria e paraburgimit

14. Në lidhje me arsyet për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(b) përcakton tri arsye (rreziqe) alternative në bazë të të cilave mund të konstatohet se paraburgimi është i domosdoshëm: (i) rreziku i arratisjes; (ii) rreziku i pengimit të procesit; ose (iii) rreziku i kryerjes së krimeve të tjera.²¹ Paraburgimi vazhdohet nëse ka arsye të artikuleshme për të besuar se një ose më shumë prej këtyre rreziqeve do të materializohen.²² Termi “të artikuleshme” në këtë kontekst përdoret në kuptimin që arsyet duhet të specifikohen me hollësi, duke iu referuar informacionit ose provave relevante.²³ Në përcaktimin nëse ekziston ndonjë prej arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) për paraburgimin e një personi, standardi i

Ndryshuar, 22 korrik 2022, para. 49(e); F00993, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës*, 29 shtator 2022, konfidencial, para. 24(b); versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë F00993/RED).

²⁰ *Shih p.sh.* IA008/F00004, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21 (versioni i redaktuar konfidencial u lëshua më të njëjtën ditë, IA008/F00004/RED).

²¹ Cf. ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016, para. 88; ECtHR, *Zohlandt v. the Netherlands*, no. 69491/16, [Judgment](#), 9 February 2021, para. 50; ECtHR, *Grubnyk v. Ukraine*, no. 58444/15, [Judgment](#), 17 September 2020, para. 115; ECtHR, *Korban v. Ukraine*, no. 26744/16, [Judgment](#), 4 July 2019, para. 155.

²² IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit”)*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 19 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA004/F00005/RED).

²³ Neni 19.1.31 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës 2022, Ligji nr. 08/L-032 përkufizon shprehjen “të artikuleshme” si: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë informatën apo provën në të cilën mbështetet”.

zbatueshëm është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që ndonjë prej rreziqeve të materializohet.²⁴

a) Rreziku i arratisjes

15. ZPS-ja parashtron se njohuritë më të mëdha të z. Krasniqi për kuadrin e çështjes, përfshirë akuzat kundër tij dhe provave që (do të) paraqiten në lidhje me këto akuza, shtojnë rrezikun që ai të arratiset.²⁵ Ajo argumenton se kjo, së bashku me konstatimet e mëparshme në lidhje me mundësitë për udhëtim të z. Krasniqi, krijon mundësi të mjaftueshme reale se ekziston rreziku i arratisjes në lidhje me z. Krasniqi.²⁶

16. Mbrojtja e Krasniqit thekson faktin se Trupi Gjykses ka hedhur poshtë vazhdimisht pretendimin e ZPS-së se z. Krasniqi paraqet rrezik për arratisje.²⁷ Gjithashtu, ajo parashtron se referencat për karakter të mirë që dhanë disa prej dëshmitarëve të ZPS-së ulin çfarëdo rreziku të pretenduar të arratisjes.²⁸ Së fundi, ajo argumenton se z. Krasniqi u është përmbajtur të gjitha protokolleve dhe ishte vetëm shembull për sjellje të mirë për 44 muajt e fundit.²⁹

17. Trupi Gjykses thekson se ZPS-ja në thelb paraqet të njëjtat argumente, të cilat Trupi Gjykses i ka shqyrtuar tashmë dhe i ka hedhur poshtë në lidhje me këtë aspekt. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e Panelit të Gjykatës së Apelit se nuk duhet të pritët nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të shqyrtojë parashtrime të cilat vetëm përsërisin argumente tashmë të trajtuara në vendimet e tij të mëparshme.³⁰ Trupi Gjykses gjykon se ky parim vlen njëjloj për fazën aktuale të procesit, dhe nuk ka konstatuar ndonjë faktor shtesë mjaftueshëm

²⁴ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit, para. 22.

²⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

²⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

²⁷ Përgjigjja, para. 5, i referohet gjithashtu Vendimit të Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 16.

²⁸ Përgjigjja, para. 5.

²⁹ Përgjigjja, para. 5.

³⁰ KSC-BC-2020-04, IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit* ("Vendimi i Apelit në Çështjen Shala"), 11 shkurt 2022, para. 18.

bindës që do të mund të ndryshonte konstatimin e mëparshëm në lidhje me rrezikun e arratisjes.³¹

18. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton, se ndonëse rreziku i arratisjes nuk mund të përjashtohet plotësisht asnjëherë, vazhdimi i paraburgimit të z. Krasniqi aktualisht nuk mund të përliqjet mbi bazën e rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i).

b) Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

19. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të këtij Trupi Gjykses, ZPS-ja parashtron se z. Krasniqi vazhdon të përbëjë rrezik për pengimin e procesit.³² Sipas ZPS-së, nxjerrja e mëtejshme e informacionit, përfshirë të identiteteve të dëshmitarëve për të cilët është shtyrë nxjerrja, shton rrezikun e pengimit.³³ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se vazhdon të ekzistojë atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve dhe e ndërhyrjeve ndaj tyre, e cila, siç është konstatuar nga Gjykata e Apelit, është një faktor i rëndësishëm kontekstual.³⁴

20. Mbrojtja e Krasniqit argumenton se nuk ekziston mundësia mjaftueshëm reale që z. Krasniqi të pengojë procesin.³⁵ Konkretisht, ajo parashtron se: (i) parashtrimet e përgjithshme janë të pamjaftueshme për të treguar se ekziston më shumë se thjeshtë mundësia që z. Krasniqi të pengojë procesin; (ii) ZPS-ja nuk ka parashtruar asnjë tregues ose fakte konkrete të reja për të vërtetuar se ekziston rreziku i pengimit të procesit; (iii) nxjerrja e mëtejshme e informacionit për z. Krasniqi nuk mjafton për të përliqjur vazhdimin e paraburgimit, sepse nuk ka

³¹ *Shih* Vendimin e Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 13-16; *shih gjithashtu* Vendimin e Apelit në Çështjen Shala, para. 18, që gjykon se një panel mund t'u referohet konstatimeve të vendimeve të mëparshme nëse është bindur se provat ose informacionet mbi të cilat u bazuan këto vendime vazhdojnë të mbështesin konstatimet e bëra në kohën e rishikimit.

³² Parashtrimet e ZPS-së, para. 11-15.

³³ Parashtrimet e ZPS-së, para 14.

³⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12.

³⁵ Përgjigjja, para. 6-8.

tregues ose fakt konkret që sugjeron se ka të ngjarë që ai të përdorë këtë informacion për të penguar procesin; dhe (iv) nuk është paraqitur asnjë provë që sugjeron se z. Krasniqi kontaktoi dhe i kërkoi ndonjërit prej dëshmitarëve që kanë dëshmuar ose dëshmia e të cilëve është pranuar me shkrim që të tërhiqnin dëshmitë.³⁶

21. Trupi Gjykes tashmë ka përcaktuar dhe përsërit se ekziston rreziku që z. Krasniqi të pengojë procesin e DHS-së duke u bazuar, midis të tjerash, në: (i) pozitën e tij me ndikim e cila, marrë së bashku me gatishmërinë dhe aftësinë për të siguruar informacion konfidencial jopublik, të çon në përfundimin e arsyeshëm se z. Krasniqi mund të marrë informacion konfidencial për aspekte të cilat aktualisht kanë lidhje me të; (ii) deklaratat e tij publike në të cilat kritikon DHS-në; dhe (iii) përmbajtjen e postimit të tij në *Facebook* të datës 24 prill 2020, ku vë në shënjestër “kolaboracionistët”.³⁷ Gjithashtu, Gjykata e Apelit ka konfirmuar se: (i) ka tregues se z. Krasniqi ka, më e pakta, predispozitën për frikësim të dëshmitarëve, për arsye të thëna më parë,³⁸ dhe (ii) në vlerësimin nëse ekziston rreziku që, në rast lirimi, z. Krasniqi të pengojë procesin, mes faktorëve të tjerë, nuk është e paarsyeshme të merren parasysh deklaratat publike të z. Krasniqi, në të cilat kritikon DHS-në, ose postimin e tij në *Facebook* të datës 24 prill 2020.³⁹

22. Siç është vënë në dukje më parë, duke pasur parasysh se gjykimi po vazhdon, emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të cenueshëm janë nxjerrë

³⁶ Përgjigjja, para. 6-8.

³⁷ *Shih* F00801, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Katërt për Paraburgimin”), 13 maj 2022, konfidencial dhe *ex parte*, para. 48 (versioni i redaktuar konfidencial, F00801/CONF/RED, dhe versioni i redaktuar publik, F00801/RED, u lëshuan më 13 dhe 24 maj 2022, përkatësisht).

³⁸ IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 62 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA002/F00005/RED); IA006/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit ndaj Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 30 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA006/F00005/RED).

³⁹ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 50.

dhe do të vazhdojnë të nxirren për Mbrojtjen e Krasniqit,⁴⁰ dhe, për rrjedhojë, do t'u bëhen të njohur një numri më të madh personash, ndër të cilët edhe z. Krasniqi. Trupi Gjykses vazhdon të mendojë se kjo, nga ana e vet, rrit rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun përpara se këta dëshmitarë të dëshmojnë.⁴¹ Në këtë kontekst, lirimi i të akuzuarit duke pasur në zotërim informacion të ndjeshëm nuk do të ndihmonte mbrojtjen efektive të dëshmitarëve që nuk kanë dëshmuar ende.⁴²

23. Gjithashtu, në lidhje me argumentin e Mbrojtjes së Krasniqit se nuk janë paraqitur prova të cilat sugjerojnë se z. Krasniqi, ose dikush i lidhur me të, kanë kontaktuar personat të cilët kanë dëshmuar ose u kanë kërkuar të tërheqin dëshmitë,⁴³ Trupi Gjykses thekson standardin e përdorur për vlerësimin e rreziqeve sipas nenit 41(6)(b), i cili nuk kërkon "shembull konkret" të një situatë në të cilën vetë z. Krasniqi ka frikësuar ose ngacmuar një dëshmitar.⁴⁴

⁴⁰ *Shih* Vendimin e Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 22; F02183, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Katërbëdhjetë për Paraburgimin"), 15 mars 2024, para. 25; F01926, Panel, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Dymbëdhjetë për Paraburgimin"), 15 nëntor 2023, para. 25; F01795, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Njëmbëdhjetë për Paraburgimin"), 15 shtator 2023, konfidencial, para. 20 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F01795/RED); F01679, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Dhjetë për Paraburgimin"), 17 korrik 2023, konfidencial, para. 26 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 9 gusht 2023, F01679/RED); F01530, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Nëntë për Paraburgimin"), 17 maj 2023, konfidencial, para. 22 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 22 maj 2023, F01530/RED); F01382, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Tetë për Paraburgimin"), 17 mars 2023, konfidencial, para. 25 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 20 mars 2023, F01382/RED).

⁴¹ F02059, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, ("Vendimi i Tretë për Paraburgimin") 15 janar 2024, para. 25.

⁴² *Shih* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 25; Vendimin e Dymbëdhjetë për Paraburgimin, para. 25; Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 20; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 26; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 22; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 25; F01212, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Shtatë për Paraburgimin"), para. 25.

⁴³ Përgjigja, para. 6.

⁴⁴ *Shih* Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 23, i referohet IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit për Lirim të Përkohshëm* ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit"), 30 prill 2021, konfidencial, para. 59 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA003/F00005/RED).

Rrjedhimisht, siç është konstatuar më parë, fakti që ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë që sugjeron se në fakt z. Krasniqi tentoi të ndërhynte ndaj dëshmitarëve nuk do të thotë se nuk mund të ekzistojë rreziku sipas nenit 41(6)(b).⁴⁵ Më e rëndësishmja, kjo nuk është në kundërshtim me konstatimin e mëparshëm të Trupit Gjykses se është duke e shqyrtuar këtë aspekt duke pasur parasysh informacionin se në Kosovë vazhdon të ekzistojë një atmosferë e përgjithshme e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në lidhje me këtë çështje dhe çështje të tjera para DHS-së.⁴⁶

24. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se, duke marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së.

c) Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

25. Duke iu referuar konstatimeve të Trupit Gjykses në Vendimin e Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin, ZPS-ja parashtron se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi të kryejë krime të tjera.⁴⁷ Sipas ZPS-së, konstatimi i Trupit Gjykses se nxjerrja e vazhdueshme e informacionit të ndjeshëm paraqet rrezik të papranueshëm për kryerjen e krimeve të tjera merr më shumë rëndësi duke pasur parasysh ecurinë në vazhdimësi të gjykimit.⁴⁸ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se duhet të merret parasysh natyra tejet e rëndë e akuzave kundër z. Krasniqi.⁴⁹

26. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se ZPS-ja nuk ka vërtetuar se ende ekziston më shumë se thjesht një mundësi që z. Krasniqi të kryejë krime të tjera.⁵⁰ Mbrojtja

⁴⁵ Vendimi i Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 19.

⁴⁶ *Shih* Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 27; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 23; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 26 *i referohet* KSC-BC-2020-05, F00494/RED/COR, Trupi Gjykses I, *Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit*, 24 janar 2023, para. 57. *Shih gjithashtu* Vendimin e Dymbëdhjetë për Paraburgimin, para. 26; Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 23.

⁴⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 16-20.

⁴⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 27.

⁴⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 19.

⁵⁰ Përgjigja, para. 10.

e Krasniqit parashtron se aspektet në lidhje me rrezikun e kryerjeve të krimeve të tjera përkojnë konsiderueshëm me ato në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit.⁵¹

27. Trupi Gjykses kujton konstatimin e vet në Vendimin e Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi të kryejë krime të tjera.⁵² Trupi Gjykses konstaton se shqetësimet dhe faktorët e njëjtë që u morën parasysh në lidhje me pengimin janë relevantë për analizën e rrezikut që z. Krasniqi të kryejë krime të tjera.⁵³ Duke i pasur parasysh ato, Trupi Gjykses gjykon se nuk ka ndryshuar asnjë nga rrethanat që nga rishikimi i fundit i paraburgimit që do të përlligjnin një konstatim të ndryshëm në lidhje me këtë pikë.

28. Duke pasur parasysh të gjithë faktorët së bashku, Trupi Gjykses gjykon se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi të kryejë krime të tjera, siç janë përcaktuar në nenin 41(6)(b)(iii).

iii. Përfundim

29. Trupi Gjykses gjykon se në këtë moment nuk ka informacion të mjaftueshëm që përlligj konstatimin se z. Krasniqi mund t'i ikë drejtësisë. Megjithatë, duke u bazuar në standardin përkatës, Trupi Gjykses është bindur se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së dhe rreziku që ai të kryejë krime të tjera kundër atyre që perceptohen se janë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi ose mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose që pritet të paraqiten para DHS-së. Trupi Gjykses do të vlerësojë më poshtë nëse kushtet për lirimin e tij mund të trajtojnë në mënyrë të përshtatshme këto rreziqe.

⁵¹ Përgjigjja, para. 10.

⁵² Vendimi i Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 26-28.

⁵³ *Shih* më lart, para. 19-24. *Shih gjithashtu* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 30.

B. MASAT ALTERNATIVE NDAJ PARABURGIMIT

30. Duke iu referuar konstatimeve të mëhershme të Trupit Gjykses, ZPS-ja parashtron se: (i) rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së; (ii) që nga Vendimi i Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin, nuk ka ndryshuar asgjë që do të përligjte një vlerësim të ndryshëm të kushteve, në përgjithësi apo për një periudhë të caktuar; dhe (iii) përkundrazi, vazhdimi i gjykimit dhe nxjerrja e mëtejshme e materialeve si rezultat i kësaj, i shtojnë këto rreziqe më shumë se kurrë.⁵⁴

31. Mbrojtja e Krasniqit argumenton se, çfarëdo rreziku i pretenduar për pengim të procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera mund të ulet në nivel të tolerueshëm ("Kërkesa për Lirim të Përkohshëm"), nëse z. Krasniqi lejohet të kalojë tri javë gjatë pushimit veror të gjykatës në vendin e përcaktuar, në varësi të masave të caktuara.⁵⁵ Mbrojtja e Krasniqit propozon kushtet në vijim:

- a) lirim për një periudhë prej tri javësh;
- b) moslejim i bërjes së deklaratave publike;
- c) qasje e kufizuar në pajisje për komunikim dhe në internet;
- d) numër i kufizuar vizitorësh; dhe
- e) monitorim i komunikimeve.⁵⁶

32. Kur vendos nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Trupi Gjykses duhet të marrë parasysh masa alternative për të shmangur rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).⁵⁷ Në nenin 41(12) përcaktohen një numër i

⁵⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 21-25.

⁵⁵ Përgjigja, para. 2, 9, 16.

⁵⁶ Përgjigja, para. 9.

⁵⁷ Sa i përket detyrimit për të shqyrtuar "masa alternative", shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Aktvendimi i DHSGJK-së i Datës 26 Prill 2017")*, 26 prill 2017, para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic*

opsioneve që duhet të merren parasysh për të garantuar praninë e të akuzuarit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo për të garantuar kryerjen me sukses të procesit penal. Në këtë aspekt, Trupi Gjykes kujton se paraburgimi duhet të vazhdohet vetëm nëse nuk ekzistojnë masa alternative më të buta dhe logjike të disponueshme, të cilat do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).⁵⁸

33. Trupi Gjykes ka konstatuar se masat alternative të përcaktuara në nenin 41(12), ndër të cilat arresti shtëpiak për një periudhë të kufizuar sipas nenit 41(12)(d), nuk mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese në këtë fazë të procesit sa i përket z. Krasniqi.⁵⁹ Trupi Gjykes kujton gjithashtu konstatimin e mëparshëm se komunikimet e z. Krasniqi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera vetëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit.⁶⁰ Trupi Gjykes ka konstatuar më parë poashtu se masat në fuqi në objektin e paraburgimit, marrë në tërësi: (i) ofrojnë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar paraprakisht për të zvogëluar rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera; dhe (ii) ofrojnë mjedis të kontrolluar ku shkelja

of Moldova, para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, *Judgment*, 22 May 2012, para. 140 *in fine*.

⁵⁸ Aktvendimi i DHSGJK-së i Datës 26 Prill 2017, para. 114; KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 Prill 2020*, 22 maj 2020, para. 70. *Shih gjithashtu* ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], para. 140 *in fine*.

⁵⁹ *Shih* Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 37, 42-48; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 6, 35-37; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 6, 34-38. *Shih gjithashtu* IA020/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit* ("Vendimi i Katërt i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit"), 2 gusht 2022, konfidencial, para. 39 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA020/F00005/RED).

⁶⁰ *Shih* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 37; Vendimin e Dymbëdhjetë për Paraburgimin, para. 39; Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 29; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 41; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 34; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 38; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 39.

e mundshme e konfidencialitetit mund të evidentohet dhe/ose parandalohet më lehtë.⁶¹

34. Në lidhje me kohëzgjatjen e kufizuar të lirimit që kërkoi Mbrojtja e Krasniqit, Trupi Gjykues ka vendosur tashmë se lloji i kufizuar i kohëzgjatjes së lirimit të përkohshëm nuk do të ndryshonte konstatimin e Trupit Gjykues se komunikimet e z. Krasniqi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera vetëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit.⁶²

35. Trupi Gjykues vëren gjithashtu se Mbrojtja e Krasniqit nuk ka treguar se si do të zbatoheshin masat e propozuara shtesë, as nuk dha hollësi për të mbështetur parashtrimin e vet se vendosja e një kombinimi të kushteve për një periudhë relativisht të shkurtër të lirimi të përkohshëm do të ulte në një nivel të tolerueshëm rreziqet e pretenduara. Trupi Gjykues konstaton se kushtet e propozuara kërkojnë monitorim të hollësishëm në vendin e përcaktuar, përfshirë brendësinë e tij. Në lidhje me këtë, edhe nëse brendësia e vendit të përcaktuar do të monitorohej gjatë periudhës së lirimit të përkohshëm jashtë ambientit të kontrolluar të objektit të paraburgimit të DHS-së, kjo sidoqoftë do të linte mundësi të konsiderueshme për forma të pakontrolluara komunikimi, përfshirë për të penguar procesin e DHS-së ose për të kryer krime të tjera.⁶³

⁶¹ *Shih* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 37; Vendimin e Dymbëdhjetë për Paraburgimin, para. 39; Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 29; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 41; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 33; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 37; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 38. *Shih gjithashtu* IA016/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit* ("Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit"), 25 mars 2022, konfidencial, para. 30 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA016/F00005/RED).

⁶² Vendimi i Dhjetë për Paraburgimin, para. 42. *Shih gjithashtu* Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 38; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 39

⁶³ *Shih* Vendimin i Dhjetë për Paraburgimin, para. 46. *Shih gjithashtu* Vendimin e Katërt për Paraburgimin, para. 68; F00582, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, ("Vendimi i Tretë për Paraburgimin"), 26 nëntor 2021, konfidencial, para. 71, 74 (versioni i redaktuar publik u

36. Trupi Gjykses Panel kujton konstatimin e vet të mëparshëm se Zyra Administrative është e vetmja që ka përgjegjësinë e drejtimit dhe administrimit të objektit të paraburgimit të DHS-së dhe ka qasje në informacion relevant, dhe i njeh në hollësi arsyet përse është e nevojshme të zbatohen masat për mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave dhe të tjerëve që rrezikohen për shkak të dëshmime të dhëna nga dëshmitarët në këtë çështje.⁶⁴ Në dallim prej saj, Policia e Kosovës nuk ka dhe nuk mund të ketë qasje në të gjithë informacionin relevant që ka lidhje me dëshmitarët, viktimat dhe të tjerët që rrezikohen për shkak të dëshmime të dhëna nga dëshmitarët në këtë çështje. Duke mos e pasur këtë informacion, Policia e Kosovës nuk është në gjendje të vlerësojë qartë rreziqet në fjalë dhe të sigurojë një shkallë mbrojtjeje të krahasueshme me atë të objektit të paraburgimit të DHS-së, veçanërisht në lidhje me nxjerrjen e informacionit konfidencial që mund të shkëmbehet.⁶⁵

37. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se kushtet e propozuara në Përgjigje nuk mund të parandalojnë mjaftueshëm z. Krasniqi që të përcjellë informacion konfidencial dhe/ose t'u kërkojë pjesëtarëve të familjes të përcjellin mesazhe gojarisht ose të përcjellin mesazhe të fshehta për të penguar procesin DHS-së ose për të kryer krime të tjera.⁶⁶

lëshua më 8 dhjetor 2021, F00582/RED); F00371, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Dytë për Paraburgimin"), 25 qershor 2021, konfidencial, para. 52 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 30 qershor 2021, F00371/RED); Vendimi i Katërt i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 33-34 (gjithashtu në lidhje me realizueshmërinë e monitorimit të komunikimeve me anëtarë të familjes drejtpërdrejt nga një zyrtar i Zyrës Administrative); Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 28.

⁶⁴ *Shih* Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 45; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 72.

⁶⁵ *Shih* Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 45. *Shih gjithashtu* Vendimin e Katërt të Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 35; Vendimin e Tretë të Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 31-32.

⁶⁶ *Shih gjithashtu* Vendimin e Katërt për Paraburgimin, para. 66; Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 70; Vendimin e Dytë për Paraburgimin, para. 52; IA006/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit ndaj Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit* ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit"), 1 tetor 2021, konfidencial, para. 52-53 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA006/F00005/RED); Vendimi i Katërt i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 29.

38. Duke qenë se nuk ka propozim të hollësishëm për zbatim efektiv të masave të propozuara nga Mbrojtja e Krasniqit, Trupi Gjykses konstaton se paraburgimi në vend të caktuar, për tre javë gjatë pushimit veror të gjykatës dhe në varësi të kushteve të diskutuara më lart, nuk ul mjaftueshëm rreziqet ekzistuese në lidhje me z. Krasniqi.

39. Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë të gjitha masat e arsyeshme alternative që mund të vendosen dhe jo vetëm ato që parashtron Mbrojtja e Krasniqit ose ZPS-ja.⁶⁷ Trupi Gjykses vazhdon të jetë i bindur se, në këtë fazë të procesit, asnjë masë shtesë sipas nenit 41(12), e urdhëruar *proprio motu*, nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm, dhe në një shkallë të krahasueshme me mbrojtjen që zbatohet në objektin e paraburgimit të DHS-së, rreziqet ekzistuese në lidhje me z. Krasniqi.

40. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses vazhdon të jetë i bindur për përfundimet e nxjerra më parë, të përmbledhura në paragrafin 33 më lart, dhe konstaton se rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së krimeve të tjera, në këtë fazë të procesit, mund të trajtohet në mënyrë efektive vetëm në qoftë se z. Krasniqi vazhdon të qëndrojë në objektin e paraburgimit të DHS-së. Në këto rrethana, Trupi Gjykses konstaton se përveç vazhdimit të paraburgimit të z. Krasniqi, nuk ka alternativa të tjera që do të mund të shmangnin në mënyrë të përshtatshme rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii), qoftë në përgjithësi apo për një periudhë të caktuar kohore.

C. ARSYESHMËRIA E PARABURGIMIT

41. ZPS-ja argumenton se, kur merren parasysh të gjithë faktorët, paraburgimi i z. Krasniqi vazhdon të jetë proporcional.⁶⁸ Për këtë qëllim, ZPS-ja i referohet konstatimeve të mëparshme të Trupit Gjykses se: (i) kundër z. Krasniqi janë ngritur dhjetë akuza për krime të rënda ndërkombëtare në të cilat pretendohet se

⁶⁷ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit, para. 86; KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit*, 25 maj 2021, para. 24.

⁶⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 26-28.

ai ka luajtur rol të rëndësishëm; (ii) nëse shpallet fajtor, ai mund të dënohet me burgim të gjatë; (iii) rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm duke zbatuar masa alternative të arsyeshme; (iv) çështja kundër z. Krasniqi është komplekse; (v) ekziston atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve e përshkruar më lart; dhe (vi) gjykimi është duke vazhduar.⁶⁹

42. Mbrojtja e Krasniqit argumenton se lejimi i z. Krasniqi për të kaluar tri javë në vendin e përcaktuar gjatë pushimit veror të gjykatës do të ishte proporcional dhe në përputhje me të drejtën e tij për jetë familjare, duke pasur parasysh moshën e shtyrë të tij dhe faktorët shtesë të paraqitur hollësisht në Përgjigje.⁷⁰ Ajo argumenton se: (i) që nga Vendimi i Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin ka pasur ndryshim në rrethanat personale të paraqitur në hollësi në versionin *ex parte* të Përgjigjes, të cilat Trupi Gjykes duhet t'i marrë parasysh;⁷¹ (ii) z. Krasniqi është në paraburgim tani 44 muaj, gjatë së cilës periudhë nuk është lejuar të vizitojë shtëpinë e tij, dhe jeta familjare e tij ka pësuar;⁷² dhe (iii) lirimi me kusht do t'i kontribuonte pozitivisht mirëqenies dhe shëndetit mendor të tij.⁷³

43. ZPS-ja kundërpërgjigjet se ndarja nga familja gjatë kohës në burg, në vetvete, nuk përbën shkelje të së drejtës së të parandaluarit për familje dhe jetë private, dhe z. Krasniqi ka qasje në të njëjtat standarde të shërbimit shëndetësor që ofrohen në shtetin pritës.⁷⁴

44. Së pari, në lidhje me pretendimin e Mbrojtjes për ndryshimin e rrethanave, Trupi Gjykes nuk është bindur se kushtet e paraburgimit në objektin e ndalimit të DHS-së, po i shkaktojnë z. Krasniqi vështirësi për t'u përballur me ndryshimet e sugjeruara të rrethanave që të përlligjin lirimin e tij tani.

⁶⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 27.

⁷⁰ Përgjigja, para. 2, 13, 15.

⁷¹ Përgjigja, para. 11-12.

⁷² Përgjigja, para. 2, 17

⁷³ Përgjigja, para. 14.

⁷⁴ Kundërpërgjigja, para. 7.

45. Së dyti, Trupi Gjykses ka parasyssh se kohëzgjatja e paraburgimit është faktor që duhet marrë parasyssh, së bashku me shkallën e rreziqeve të përshkuara në nenin 41(6)(b), për të vlerësuar nëse, kur merren parasyssh të gjithë faktorët, vazhdimi i paraburgimit “pushon së qeni i arsyeshëm” dhe personi duhet të lirohet.⁷⁵ Trupi Gjykses rikujton se arsyeshmëria e vazhdimit të mbajtjes në paraburgim të të akuzuarit duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të secilës çështje dhe sipas veçorive të saj.⁷⁶ Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, karakteristikat e veçanta në këtë çështje përfshijnë si në vijim: (i) kundër z. Krasniqi janë ngritur dhjetë akuza për krime të rënda ndërkombëtare në të cilat pretendohet se ai ka luajtur rol të rëndësishëm;⁷⁷ (ii) nëse shpallet fajtor, z. Krasniqi mund të dënohet me burgim të gjatë; (iii) vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) dhe ato nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm duke zbatuar masa alternative të arsyeshme;⁷⁸ (iv) çështja kundër z. Krasniqi është komplekse;⁷⁹ (v) ekziston atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve; dhe (vi) fakti që gjykimi është duke vazhduar.

46. Së treti, Trupi Gjykses ka parasyssh gjithashtu argumentin e Mbrojtjes se jeta familjare e z. Krasniqi ka pësuar. Trupi Gjykses konstaton se e drejta e z. Krasniqi për jetë familjare, deri në një shkallë, është vetvetiu e kufizuar nga paraburgimi, por po merren të gjithë hapat e arsyeshëm, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe standarde të njohura ndërkombëtarisht për trajtimin e personave të cilëve u hiqet liria. Trupi Gjykses është i mendimit se lirimimi me kusht për një periudhë të shkurtër pa dyshim do të ndihmonte

⁷⁵ Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 43, *i referohet* Vendimit të Parë të Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 69.

⁷⁶ Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 43.

⁷⁷ Aktakuza e Konfirmuar, para. 10-12, 32, 39-40, 44, 49, 53, 55-57, 176-177.

⁷⁸ *Shih më lart*, para. 30-35.

⁷⁹ *Shih p.sh.* Vendimin e Gjashtë për Paraburgimin, para. 59; F00978, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 19 shtator 2022, konfidencial, para. 58 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 23 shtator 2022, F00978/RED); Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para, para. 81.

mirëqenien dhe shëndetin mendor të z. Krasniqi. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se vazhdimi i paraburgimit të tij ka pushuar së qeni i arsyeshëm – sidomos duke marrë parasysh veçoritë konkrete të përmendura më lart në këtë çështje gjyqësore.

47. Së fundi, duke mbajtur parasysh se, për vlerësimin e përshtatshmërisë së paraburgimit të një personi, mosha është një ndër faktorët që duhet të merret parasysh sipas nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut,⁸⁰ Trupi Gjyqësor është bindur se shëndeti dhe mirëqenia e z. Krasniqi aktualisht ruhen mjaftueshëm në objektin e paraburgimit të DH-së dhe se mosha e z. Krasniqi nuk e bën të paarsyeshëm paraburgimin e tij.

48. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjyqësor konstaton se paraburgimi i z. Krasniqi edhe për dy muaj shtesë është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm në rrethanat konkrete të çështjes.

49. Megjithatë, Trupi Gjyqësor vë në dukje se z. Krasniqi tashmë është në paraburgim për një kohë të konsiderueshme, dhe se gjykimi në këtë çështje është i gjatë. Siç ka vënë në dukje Trupi Gjyqësor më parë,⁸¹ kjo kërkon nga Trupi Gjyqësor, si dhe nga palët, të kenë sidomos parasysh nevojën për të siguruar kryerjen sa më të shpejtë të gjykimit. Trupi Gjyqësor do të vazhdojë në çdo fazë të këtij procesi të monitorojë nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm. Trupi Gjyqësor rikujton gjithashtu se ai mund të urdhërojë lirim për arsye humanitare për një periudhë të shkurtër, në qoftë se rrethanat personale të z. Krasniqi përbëjnë arsye bindëse humanitare që përlligjin një lirim të tillë në të ardhmen.⁸²

⁸⁰ *Shih gjithashtu* Vendimin e Pestë për Paraburgimin, para. 62; Vendimin e Katërt për Paraburgimin, para. 83; ECtHR, *Mouisel v. France*, no. 67263/01, [Judgment](#), 14 November 2002, para. 38.

⁸¹ *Shih p.sh.* Vendimin e Pesëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 40; Vendimin e Katërmëdhjetë për Paraburgimin, para. 47; Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 49; Vendimin e Katërmëdhjetë për Paraburgimin, para. 49; Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 35; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 56; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 39; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 44; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 46.

⁸² Rregulla 56(3).

V. KLASIFIKIMI

50. Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja e Krasniqit dorëzoi Përgjigjen si konfidenciale dhe *ex parte* dhe parashtrori versionin e redaktuar konfidencial të Përgjigjes. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen të parashtrorjës versionin e redaktuar publik të Përgjigjes deri të hënë, 22 korrik 2024.

VI. VENDIM

51. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **HEDH POSHTË** Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për Lirim me Kusht;
- b) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Krasniqi;
- c) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Krasniqi jo më vonë se **të premten, 23 gusht 2024 (ora 16:00)**, me parashtrimet përkatëse me shkrim sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76; dhe
- d) **URDHËRON** Mbrojtjen e Krasniqit të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Përgjigjes deri **të hënë, 22 korrik 2024**.

_____/nënshkrimi/_____

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E hënë, 15 korrik 2024

Në Hagë, Holandë.